



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Drejtoria e Bujqësisë

## THIRRJE PËR APLIKIM

Njoftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës se mund të aplikojnë për:

**- Përkrahje me sistem të ujitjes pikë-pikë**

### **Kriteret e përcaktuara për përkrahje me sistem të ujitjes pikë-pikë:**

- Aplikuesi ta ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës dhe të jetë banor i saj;
- Sipërfaqja e mbjellë me pemë duhet të jetë nga 0,30 - 1,00 ha;
- Sipërfaqja e mbjellë me perime në ambient të hapur duhet të jetë nga 0,30 - 1,00 ha;
- Sipërfaqja e mbjellë me perime në ambient të mbyllur duhet të jetë nga 0,03 - 0,20 ha.
- Përparësi do të kenë fermerët që kanë të mbjellë sipërfaqe më të madhe me pemë dhe perime;
- Nuk mund të jenë përfitues fermerët të cilët janë përkrahur me sistemit të ujitjes pikë-pikë dhe mjedër;
- Përfituesi duhet të jetë banor dhe të ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës.

### **Dokumentacioni i nevojshëm**

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi për llogarinë bankare ;
- Fatura e furnizimit me sistem të ujitjes;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme, me afat deri në një vit;

**Data e aplikimit, prej 30.03. deri 12.04.2017.**